



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.27

21 mars

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Urdhër i MASH
nr.102, datë 17.2.2010

Për miratimin e paketës informuese “Altertekst 2010-2011” 827

URDHËR
Nr.102, datë 17.2.2010

PËR MIRATIMIN E PAKETËS INFORMUESE “ALTERTEKST 2010-2011”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 106 dhe 107 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë“, me propozim të komisionit për miratimin e teksteve

URDHËROJ:

- I. Miratimin e paketës informuese “Altertekst 2010-2011”, e cila përmban:
1. Kërkesën për tekste shkollore;
 2. Udhëzime të përgjithshme për përdorimin e teksteve shkollore në shkollat e Republikës së Shqipërisë;
 3. Tekste të përkthyer dhe të pakicave kombëtare;
 4. Tekste të gjuhës dhe kulturës shqiptare për fëmijët e emigrantëve shqiptarë që jetojnë në vende të huaja;
 5. Vlerësimin e tekstit shkollor;
 6. Dokumentet që botuesi i dorëzon për miratim teksti;
 7. Koeficientët e formulës së vlerësimit të çmimit;
 8. Specifikimet teknike të teksteve të kërkuara;
 9. Tekstet që do të përdoren për vitin shkollor 2010-2011;
 10. Kontratën midis shtëpive botuese dhe MASH-it;
 11. Të dhënat për autorët e teksteve;
 12. Deklaratën për pajtueshmërinë me ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar;
 13. Deklaratën për të drejtën e botimit të tekstit;
 14. Deklaratën për specifikime teknike të tekstit;
 15. Deklaratën për çmimin e tekstit;
 16. Deklaratën për autorësinë e tekstit.
- II. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, komisioni i miratimit të teksteve.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

PAKETA INFORMUESE
“ALTERTEKST 2010-2011”

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 67, datë 10. 02. 2010, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar” dhe të Urdhrit nr. 82, datë 9. 02. 2010 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit për Miratimin e Teksteve Shkollore”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), shpall kërkesën për tekste shkollore për vitin shkollor 2010-2011 dhe për vitin shkollor 2011-2012, si më poshtë:

I. KËRKESA PËR TEKSTE SHKOLLORE

1. Për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore për vitin shkollor 2010-2011 do të shpallet konkurrimi:

- a) për tekstet e klasës XI;
- b) për metoda origjinale të gjuhëve të huaja të klasave III-XII;
- c) për tekste të tabelës “Specifikimet teknike të teksteve të kërkuara” për vitin shkollor 2010-2011;
- d) për tekstet gjuhë shqipe klasa IX , informatikë klasa IX, histori klasa XII.

2. Për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore për vitin shkollor 2011-2012 do të shpallet konkurrimi për:

- a) tekste të klasës XII;
- b) tekste për fëmijët e emigrantëve shqiptarë që jetojnë në vende të huaja;
- c) tekste të tabelës “Specifikimet teknike të teksteve të kërkuara” për vitin shkollor 2010-2011;
- d) tekste të lëndëve: Kimi, Fizikë, Biologji dhe Shkencë e tokës, të klasës X;
- e) tekste të shtojcës së këtij “Alterteksti”.

3. Datat e shpalljes së fillimit të konkurrimit të jenë:

- a) Viti shkollor 2010-2011 Shkurt 2010
- b) Viti shkollor 2011-2012 Mars 2010

4. Datat e dorëzimit të teksteve shkollore të jenë:

- a) Për vitin shkollor 2010-2011
 - a) Dorëzimi i teksteve 3-4 Maj 2010
 - b) Ngritja e Komisioneve të Vlerësimit të Teksteve (KVT) 7 Maj 2010
 - c) Vlerësimi i teksteve nga KVT-të 10-15 Maj 2010
 - d) Shpallja e fituesve 20 Maj 2010
 - e) Dhënia e lejes së certifikimit 30 Maj 2010
 - f) Dërgimi i teksteve për përzgjedhje 31 Maj-10 Qershor 2010
 - g) Përzgjedhja e teksteve në shkolla 15 Maj-20 Qershor 2010
 - h) Porositja e teksteve 26-30 Qershor 2010
 - i) Lidhja e kontratës 10-30 Qershor 2010
 - j) Shpërndarja e teksteve nga shtëpitë botuese në DAR/ZA 1-31 Gusht 2010
 - k) Marrja dhe shitja e librit në shkolla 25 gusht 15 Shtator 2010

b) Për vitin shkollor 2011-2012

- a) Dorëzimi i teksteve 1 Shkurt 2011
- b) Ngritja e KVT-së 3 Shkurt 2011
- c) Vlerësimi i teksteve nga KVT-të 4-9 Shkurt 2011
- d) Shpallja e fituesve 12 Shkurt 2011
- e) Dhënia e lejes së certifikimit 21 Shkurt 2011
- f) Dërgimi i teksteve për përzgjedhje 24-28 Shkurt 2011

| | |
|----------------------------------------------------------|------------------------|
| g) Përzgjedhja e teksteve në shkolla | 10 Shkurt-10 Mars 2011 |
| h) Porositja e teksteve | 12-15 Mars 2011 |
| i) Lidhja e kontratës | 15-25 Prill 2011 |
| j) Shpërndarja e teksteve nga shtëpitë botuese në DAR/ZA | 1-31 Gusht 2011 |
| k) Marrja dhe shitja e librit në shkolla | 25-15 Shtator 2011 |

5. Ftohen të gjitha shtëpitë botuese të paraqesin variantet e tyre të teksteve për miratim dhe më pas të marrin pjesë në tregun konkurrues, i cili do të funksionojë në përputhje me vendimin e mësipërm. Paketa informuese “Altertekst 2010-2011” merret pranë sekretarisë së Komisionit të Miratimit të Teksteve (KMT) në MASH.

6. Nuk pranohet pjesëmarrja në konkurrim për rastet që bien ndesh me Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, sipas paragrafit përkatës në Paketën Informuese “Altertekst 2010-2011”.

7. Paketa informuese “Altertekst 2010-2011” si dhe çdo material tjetër shpjegues, u jepet vetëm shtëpive botuese dhe sigurohet në sekretarinë e Komisionit të Miratimit të Teksteve në MASH, përkundrejt pagesës: 2000 lekë për paketën informuese “Altertekst 2010-2011” dhe 300 lekë për çdo program mësimor, të derdhura për llogari të MASH-it në bankat e nivelit të dytë ose në zyrat e Postës Shqiptare. Është e detyrueshme marrja e programit mësimor në se do të konkurrohet me atë tekst shkollor që e përmban.

8. Për çdo informacion tjetër, mund të kontaktoni me sekretarinë e KMT-së ose me postë elektronike në adresën: pmilo@mash.gov.al.

II. UDHËZIME TË PËRGJITHSHME PËR PËRDORIMIN E TEKSTEVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Hartimi i programeve mësimore

a) Hartimi dhe miratimi i standardeve lëndore të përmbajtjes, i planeve dhe programeve mësimore kryhet nga MASH-i nëpërmjet Institutit të Zhvillimit të Arsimit dhe Komisionet lëndore me ekspertë të jashtëm, në përputhje me politikat e zhvillimit të arsimit në vend.

2. Miratimi i teksteve shkollore

a) Miratimi i teksteve shkollore bëhet nga “Komisioni për Miratimin e Teksteve Shkollore” (KMT) pranë MASH-it, i cili shpall: kërkesën për tekste shkollore, standardet e miratimit të tyre si dhe kryen gjithë procesin e vlerësimit dhe të miratimit. KMT-ja vepron sipas rregullores së miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Vendimet e KMT-së mund të apelojnë në rrugë administrative dhe më pas në rrugë gjyqësore.

b) KMT-ja vendos për miratimin ose mosmiratimin e tekstit duke u mbështetur në plotësimin e standardeve në tri aspekte: të përmbajtjes, të cilësive fizike të tekstit dhe të çmimit.

c) KMT-ja ngre Komisionet e Vlerësimit të Teksteve (KVT) sipas lëndëve apo grup lëndëve. Këto komisione shqyrtojnë çdo tekst të paraqitur nga botuesit, nëse ai është në përputhje me standardet e përmbajtjes, të shpallura nga KMT-ja. Vlerësimet e tyre i shërbejnë KMT-së si mbështetje për vendimin përfundimtar.

d) KMT-ja miraton paketën e teksteve të lëndës, të paraqitur nga shtëpia botuese, që nënkupton tekstet bazë si dhe tekstet për punë të pavarur nga nxënësi (fletë pune, fletore laborator, etj.), kur këto janë shpallur në kërkesën e MASH-it. Nëse njëri prej teksteve të paketës nuk miratohet, atëherë e gjithë paketa nuk miratohet për përdorim në shkolla.

e) Shpallja e miratimit të fituesit bëhet publikisht në prani të botuesve të përfshirë në proces. Në rast se teksti nuk shpallet fitues, shtëpia botuese mund të bëjë ankesë me shkrim drejtuar KMT-së për t’u njohur me arsyet e refuzimit. Gjithashtu, nga KMT-ja jepen edhe vërejtjet dhe sugjerimet e vlerësimeve të bëra për tekstin e paraqitur.

f) Afati i paraqitjes së ankesës është deri në 5 ditë pune pas shpalljes së miratimit. Pas këtij afati nuk pranohen më ankesa.

g) Kur teksti i miratuar është i shtypur dhe është bërë gati për përdorim, shtëpia botuese e paraqet atë në KMT dhe kjo verifikon realizimin apo mosrealizimin e cilësive dhe specifikimeve

teknike, në të cilat është mbështetur miratimi i tij. Vetëm pas këtij verifikimi, shtëpia botuese merr certifikatën e lejes nga KMT-ja për shitjen e tekstit në shkolla. Tekstet e certifikuar nga MASH-i ndalohet të shiten dhe të përdoren në shkolla pa vendosur pullën e certifikimit.

h) Certifikimi i tekstit bëhet kur shtëpia botuese sjell dy kopje me kopertinë në KMT, nga të cilat njëra është me firmat e autorëve faqe për faqe. Kopertina e librit duhet të ketë përaftrim me përmbajtjen dhe moshën e nxënësit. Ajo nuk mund të përdoret për reklamë të kompanive, individëve, organizatave, etj.

i) Teksti i certifikuar mund të ribotohet dhe të hidhet në treg edhe për vitet e ardhshme, vetëm nëse figuron në katalogun e teksteve të ribotuar që Alterteksti i atij viti do të shpallë. Kjo do të varet nga: programi i lëndës; nga cilësia e përmbajtjes së tekstit; nga ankesat që vijnë nga përdoruesit e këtij teksti në shkolla; nga gabimet që mund të përmbajë teksti, që s'janë vënë re nga KVT-ja, apo kanë dalë gjatë përdorimit të tij të përditshëm në shkollë dhe nga cilësi të tjera të tekstit që cenojnë vlerën e tij.

j) Kërkesa që MASH-i bën për tekste shkollore varet nga: ndryshimi i planeve dhe programeve mësimore; nga mbarimi i afatit kohor të lejes së certifikimit; nga cilësia e teksteve shkollore në treg; nga moszbatimi si duhet i kontratave me shtëpitë botuese dhe nga raste të veçanta që paraqiten.

k) KMT-ja mirëpret çdo korrigjim që shtëpia botuese i bën tekstit të botuar më parë me qëllim që ta ribotojë atë. Për të arritur këtë, shtëpia botuese i adresohet KMT-së me një letër zyrtare, ku përshkruan angazhimet për ndryshimet që do t'i bëjë tekstit, me qëllim që ribotimi të rrisë cilësinë e tij. KMT-ja është e detyruar të japë përgjigje, nëse teksti do të ribotohet duke marrë parasysh korrigjimet e mundshme, ose nuk do të ribotohet, ose do të vërë në lëvizje KVT-të për të bërë rivlerësim të tekstit.

3. Shtëpitë botuese

a) Çdo shtëpi botuese ka të drejtë të marrë pjesë në konkurrimin për tekstet shkollore, nëse e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

b) MASH-i bashkëpunon me shtëpi botuese që japin garanci për realizimin e detyrave dhe i kanë realizuar brenda afateve të caktuara detyrat e një viti më parë.

c) MASH-i bën kontrata me shtëpitë botuese, me afat njëvjeçar.

d) Shtëpia botuese është e detyruar të japë informacionin e mëposhtëm:

d.1 Të dorëzojnë në KMT një deklaratë noteriale të autorëve, të cilët pranojnë botimin e tekstit nga kjo shtëpi botuese.

d.2 Në rast se teksti është për ribotim, të kenë dorëzuar në KMT një deklaratë noteriale të autorëve, të cilët pranojnë që teksti të ribotohet.

d.3 Të japin të dhënat për autorët e teksteve, sipas formularit bashkëngjitur kësaj pakete.

d.4 Të japin të dhënat për realizimin editorial në faqen e brendshme të tekstit shkollor.

d.5 Të japin të dhënat për redaktorët shkencorë, redaktorët letrarë, si dhe vendet ku ata punojnë. (modeli bashkëngjitur).

d.6 Të japin vitin e krijimit të saj, adresën, numrin/at e telefonit, adresën elektronike dhe adresën e magazinës së saj nga do të shpërndahen librat nëpër DAR/ZA.

d.7 Të dorëzojnë të dhënat e mësipërme (pika 6.) për shpërndarësin në secilën DAR/ZA.

e) Shtëpisë botuese nuk i lejohet :

e.1 Të konkurrojnë me mbi një alternativë të së njëjtës lëndë, për të njëjtën klasë. Të dorëzojë tekst pa dy recensa, (njëri nga recensuesit duhet të jetë detyrimisht pedagog efektiv në universitet), pa redaktor shkencor, pa redaktor letrar, pa disenjues.

e.2 Të pranojë tekste nga autorë që nuk kanë formim universitar së paku 4-vjeçar.

f) Shtëpia botuese merr përsipër dhe mban përgjegjësi për:

f.1 Marrëdhëniet e saj me autorët e teksteve;

f.2 Përgatitjen për shtyp të teksteve origjinale;

f.3 Marrjen e porosive për tekste, nga shkollat;

f.4 Shtypjen e teksteve;

f.5 Shpërndarjen e teksteve shkollore në shkolla.

g) Shtëpia botuese shpërndan një kopje të tekstit shkollor, të certifikuar, në shkolla për të reklamuar punën e saj ose, detyrimisht, 10 kopje në secilën DAR dhe 5 kopje në çdo ZA. Shpenzimet për kopjet e shpërndara përballohen nga vetë shtëpia botuese.

h) Nëse shtëpia botuese nuk zbaton pikën 3/g, teksti i saj nuk futet në Komisionin e Përzgjedhjes së Teksteve (KPT-të) e asaj DAR-je apo ZA-je.

i) Shtëpia botuese është e detyruar që, në kopertinën e çdo kopjeje të tekstit, të shënojë çmimin, barkodin dhe pullën me hologramën e certifikimit nga MASH-i, përpara nxjerrjes së tij në shitje.

4. Autorët e teksteve shkollore

a) Autorët i rregullojnë marrëdhëniet me shtëpitë botuese nëpërmjet kontratave që lidhin me to.

b) Autorët, të cilët nuk kanë rinovuar kontratat e tyre me shtëpitë botuese dhe këto, nuk kanë më të drejtë mbi punën e tyre, mund të lidhin kontratë me një shtëpi botuese tjetër. Në këtë rast, teksti shkollor me shtëpi botuese tjetër, do të hyjë në paketën “Altertekst 2010-2011”, por do t’i nënshtrohet certifikimit të ri, ndërsa teksti me shtëpinë botuese të vjetër, nuk futet në ribotim.

c) Të gjithë këta autorë duhet t’i drejtohen KMT-së me shkrim, për të bërë ndryshimet përkatëse, mbi bazën e kërkesës së tyre dhe dokumentacionit të paraqitur.

d) Nuk lejohet që një autor të konkurrojë, në të njëjtën klasë dhe të njëjtën lëndë, me më shumë se një libër, në shtëpi botuese të ndryshme.

5. Konflikti i interesit

a) Punonjësi i MASH-it, KMT-së, IZHA-së, AFP-së, AVA-s, APRIAL-it, IKAP-it, DAR/ZA-ve, nuk mund të jetë autor teksti, pronar shtypshkronje, ose i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me një shtëpi botuese.

b) Personat të cilët janë autorë tekstesh të katalogut të “Altertekstit” të atij viti nuk mund të jenë autorë të Komisionit të Vlerësimit të Teksteve (KVT).

c) Kur punonjësi ose personi ka konflikt interesi sipas pikës a) dhe b) atëherë konflikti zgjidhet në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi.

d) Mësuesi ose drejtori që janë autorë të një ose disa teksteve të certifikuar, nuk mund të jenë anëtarë të Komisioneve të Përzgjedhjes së Teksteve (KPT). Teksti/tekstet e tilla nuk mund të zgjidhen nga shkolla ku punon autori/autorët.

e) Nuk lejohet që në shkolla të hyjnë autorë tekstesh, pronarë shtëpish botuese, shpërndarës librash të gjuhëve të huaja për të reklamuar librat e tyre.

f) Kur vërtetohen raste të tilla si të pikës 5/e), KMT-ja ka të drejtë t’i heqë subjektit ose autorit lejen e certifikimit të tekstit.

6. Përzgjedhja e tekstit në shkolla

a) Drejtoria Arsimore Rajonale organizon procesin e përzgjedhjes së teksteve sipas procedurave të caktuara nga MASH-i.

b) Përzgjedhja e teksteve që do të përdoren në shkolla bëhet nga Komisionet e Përzgjedhjes së Teksteve.

c) Komisionet e Përzgjedhjes së Teksteve ngrihen nga sektori i kualifikimit i DAR/ZA-ve, i cili është organi përgjegjës për zhvillimin normal të punës së këtyre komisioneve.

d) Komisionet e Përzgjedhjes së Teksteve në klasat VI-IX dhe X-XII të përbëhen nga mësuesit që zhvillojnë lëndë të njëjtë me titullin e tekstit; p.sh: në klasat VI-XII tekstet e historisë do të zgjidhen vetëm nga mësuesit e historisë, etj.

e) Komisionet e Përzgjedhjes së Teksteve në klasat I-V përbëhen nga mësuesit e klasës së parë, që zgjedhin setin e klasës së parë, mësuesit e klasës dytë që zgjedhin setin e librave të klasës së dytë, e kështu me radhë, me përjashtim të gjuhës së huaj që përzgjidhet si në klasat VI-XII.

f) Anëtarët e KPT-ve fillojnë punë me leximin e teksteve që janë në ribotim sipas afatit të përcaktuar në “Altertekst”.

g) Komisioni i Përzgjedhjes së Teksteve zhvillon të paktën dy mbledhje të dokumentuara gjatë kohëzgjatjes së tij. Mbledhja e parë dhe e fundit zhvillohen në datat e përcaktuara në

“Altertekst”. Në mbledhjen përfundimtare, përpara votimit, të gjithë anëtarët duhet të kenë lexuar të gjitha alternativat.

h) Zgjedhja e tekstit të bëhet me votim të fshehtë, mbi bazën e një dokumentacioni që ruhet në drejtorinë e shkollës ku zhvillohet votimi. Fitues është teksti që merr shumicën e votave.

i) Votimi bëhet për të gjitha alternativat e tekstit shkollor të atij viti, që pasqyrohen në “Altertekst”.

j) Komisionet e përzgjedhjes së teksteve përbëhen nga jo më pak se 10 mësues, me arsimin përkatës. Sektori i kualifikimit në DAR/ZA, trajnon dhe kontrollon përgatitjen e mësuesve për votim. Në komision merr pjesë dhe një anëtar i bordit ose këshillit të prindërve, pa të drejtë vote. Vendin (shkollën) ku do të zhvillohet votimi dhe mbajtjen e dokumentacionit përkatës e vendos ky sektor.

k) Nëse për DAR/ZA-në nuk është e mundur të formojë një komision të tillë për disa lëndë, atëherë mund ta formojë këtë komision me mësues nga lëndë të përafërta.

l) Mbi bazën e votimit të fshehtë në këto komisione, mësuesi përkatës dhe drejtori i shkollës harton porosinë për shtëpinë botuese. Çdo shkollë e bën porosinë nëpërmjet drejtorit të saj, me postë të sigurt, në shtëpinë botuese, duke marrë për bazë rezultatin e votimit që shpallet nga komisioni në fund të procesit.

m) KPT-të e marrin listën e teksteve të certifikuara nga KMT-ja dhe bëjnë përzgjedhjen brenda afateve të përcaktuara për vitin e ardhshëm shkollor.

n) Drejtori i shkollës njofton me shkresë zyrtare DAR/ZA-në dhe kjo e fundit MASH-in për llojet dhe sasinë e teksteve të përzgjedhura nga shkollat, jo më vonë se 5 ditë nga data e shpallur e dhënies së porosisë.

o) Në shkolla nuk lejohet asnjë aktivitet i shtëpive botuese apo autorëve, që ka për qëllim reklamimin e librave të tyre, me përjashtim të dorëzimit dhe pranimit nga shkolla, të tekstit të certifikuar dhe materialeve të tjera që e shoqërojnë atë, si tekst mësuesi, CD, shtjellim të programit mësimor, etj.

p) KPT-të votojnë për të gjithë alternativat që janë përfshirë në “Altertekst 2010-2011” dhe tekstet e certifikuara të reja.

q) Ndalohet ndërhyrja e drejtuesve të arsimit, përfaqësuesve të shtëpive botuese, si dhe propaganda e mësuesve për favorizimin e njëres prej alternativave të paraqitura.

r) Në rast se ndodh kjo, ndaj drejtuesve ose mësuesve të shkollave, ndaj drejtuesve të DAR/ZA-ve do të merren masa administrative, ndërsa ndaj shtëpive botuese do të merret masa e përjashtimit nga “Alterteksti” për një periudhë deri 2 vitesh mësimorë.

s) Për mbledhjen e KPT-së mbahet një procesverbal i hollësishëm i cili firmoset nga të gjithë pjesëmarrësit. Për çdo tekst të përzgjedhur jepet një argumentim. Procesverbali ruhet një vit. Një kopje e tij i dërgohet DAR/ZA-së përkatëse.

7. Porositja dhe shitblerja e teksteve

a) DAR/ZA-të ngarkohen për monitorimin e shpërndarjes dhe shitjes së librit shkollor.

b) DAR/ZA-të i vënë në dispozicion shpërndarësit, të ngarkuar nga shtëpitë botuese, një ose dy mjedise grumbullimi librash pa pagesë, në rast se ata dëshirojnë, në nivel DAR/ZA për periudhën 1 gusht - 30 shtator.

c) Shkollat i vënë në dispozicion personave të ngarkuar nga shpërndarësit e rrethit (librashitësit), një ose dy klasa të sigurta për shitjen e librave, për të gjitha shtëpitë botuese, për periudhën 10 gusht - 30 shtator,

d) DAR/ZA-të dhe drejtoritë e shkollave t’u krijojnë kushte lehtësuese shpërndarësve të teksteve shkollore por, njëkohësisht dhe t’i monitorojnë ata për zbatimin e kësaj pakete. Gjithashtu, ato ngarkojnë njërin nga specialistët e tyre si person përgjegjës (pikë kontakti), që mban lidhje të vazhdueshme me KMT-në dhe informon për mbarëvajtjen e procesit.

e) Gjatë muajit qershor DAR/ZA-të hartojnë planin e veprimit të shpërndarjes dhe shitjes së librit shkollor, me të gjitha detajet e veçanta të këtij procesi.

f) Shtëpitë botuese të shesin librin shkollor në shkollë.

g) Në klasën ku shitet libri shkollor të vendoset, në vendin më të dukshëm, lista e teksteve shkollore të certifikuara, që ka përzgjedhur shkolla, çmimet e tyre si edhe shënimi me shkronja të mëdha: “Programi shkollor përdor vetëm tekstet që kanë pullën e MASH-it “.

h) Shitja me detyrim ose me mashtrim e librave që nuk kanë pullën e MASH-it, së bashku me tekstet shkollore është kategorikisht e ndaluar.

i) Në rast se kjo ndodh në shkollë, ndaj drejtorit të ngarkuar për të monitoruar procesin merret masa e largimit nga detyra.

j) Drejtorët e shkollave, gjatë muajve maj-qershor të bëjnë një studim paraprak për numrin e teksteve shkollore që do të porositin, për çdo lëndë, klasë dhe vit, në mënyrë që numri i teksteve të porositura të jetë sa më real.

k) DAR/ZA-të gjatë katër javëve para fillimit të vitit të ri shkollor, të raportojnë në MASH çdo ditë, në mënyrë të vazhdueshme për shpërndarjen dhe blerjen e teksteve.

8. Shpërndarësit e librave

a) Shtëpitë botuese marrin përsipër shpërndarjen e teksteve shkollore të certifikuara në afatet e caktuara.

b) Shtëpitë botuese ose shpërndarësit e caktuar prej tyre duhet të bashkëpunojnë ngushtë me DAR/ZA-të përkatëse për realizimin e afateve të caktuara si edhe në lidhje me pikat e grumbullimit dhe të shitjes së teksteve shkollore.

c) DAR/ZA-të, në bashkëpunim me librashitësit, caktojnë pikat e shitjes së librit shkollor në shkolla.

d) Nëse shpërndarësit ose librashitësit e teksteve shkollore të shtëpive botuese dalin jashtë kontrollit të DAR/ZA-ve, MASH-i do të rishikojë bashkëpunimin me shtëpinë botuese që ka këtë shpërndarës ose librashitës.

III. TEKSTET E PËRKTHYERA DHE TEKSTET E SHKOLLAVE TË PAKICAVE KOMBËTARE

a) Në lëndën Gjuhë e huaj, në shkollë të mesme, konkretisht në klasat XI dhe XII, do të përdoren vetëm metoda origjinale të gjuhëve të huaja.

b) Në lëndën Gjuhë e huaj, në shkollën 9-vjeçare, do të përdoren njëkohësisht metodat origjinale dhe tekstet për mësimin e gjuhëve të huaja, me autorë shqiptarë.

c) Në klasën X do të përdoren tekstet e përkthyer të lëndëve: kimi, fizikë, biologji, shkenca e tokës, të përmirësuara mbi bazën e vërejtjeve të paraqitura.

d) Në klasën XI do të përdoren tekstet: kimi, fizikë, biologji, të përkthyer, me çmime si ato të klasës X.

e) Për tekstet e shkollave të pakicave kombëtare greke dhe maqedonase ndiqen kriteret dhe procedura të njëjta, si më sipër.

IV. TEKSTET PËR MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE NGA FËMIJËT E EMIGRANTËVE SHQIPTARË QË JETOJNË NË VENDE TË HUAJA

1. MASH-i kërkon të botojë tekste në linjë për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare nga emigrantët shqiptarë që jetojnë në vende të huaja, me titull:

a) “Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 1 ”

b) “Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 2”

c) “Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 3”,

me synim mësimin e gjuhës shqipe, të folur dhe të shkruar, me njohuri nga historia, gjeografia dhe kultura shqiptare, nga fëmijë të emigrantëve që jetojnë në vende të huaja për klasat I-V, VI-IX dhe X-XII.

V. VLERËSIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE

1. Kriteret e vlerësimit të përmbytjes

Përmbytja e tekstit do të vlerësohet sipas këtyre treguesve:

| Nr. | Treguesit dhe nëntreguesit e vlerësimit | Min. | Max. |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|------|
| 1 | Përputhja me kërkesat e kurrikulës. | 8 | 10 |
| a) | A përmbush teksti objektivat e programit mësimor? | 3 | 4 |
| b) | Si janë realizuar raportet njohuri të reja/përforcim dhe integrimi i lëndëve, sidomos Gjuhë shqipe dhe letërsi? | 2 | 3 |
| c) | A ka teksti shmangie nga programi mësimor? | 3 | 3 |
| 2 | Përmbytja e tekstit. | 15 | 20 |
| a) | A dallon teksti për saktësi shkencore? | 9 | 10 |
| b) | A është treguar kujdes për të nxjerrë faktet themelore të temës mësimore dhe në ç' mënyrë? | 2 | 4 |
| c) | A është vëllimi i njohurive në përshtatje me moshën e nxënësve? | 2 | 3 |
| d) | A respekton teksti barazinë gjinore, racën, kombësinë, fenë dhe parimet demokratike? | 2 | 3 |
| 3 | Niveli i gjuhës. | 6 | 10 |
| a) | A është e përshtatshme gjuha e përdorur për nivelin e nxënësve të klasës për të cilën është ndërtuar teksti? | 5 | 7 |
| b) | A është shkruar saktë nga pikëpamja gjuhësore? | 1 | 3 |
| 4 | Prezantimi dhe ilustrimet. | 5 | 10 |
| a) | A ka lidhje ilustrimi me përmbytjen e tekstit? | 3 | 5 |
| b) | Sa nxit autori i tekstit motivimin e nxënësve për njohuritë e reja? | 1 | 2 |
| c) | Standardi, cilësia e ilustrimeve, estetika e librit, stili. | 1 | 3 |
| 5 | Përshtatshmëria e tekstit mësimor në rrethanat e klasës, nevojat e nxënësve dhe dobishmëria e ushtrimeve, detyrave; vlerësimi i tyre sipas niveleve dhe materialet testuese. | 7 | 18 |
| a) | Sa e ndihmon nxënësin teksti me detyra testuese? | 4 | 7 |
| b) | A i përshtatet tema mësimore dhe zbatimet praktike të saj realitetit bashkëkohor? | 2 | 5 |
| c) | A dallon teksti për një trajtim të qartë të njohurive? | 2 | 4 |
| d) | A janë trajtuar zbatimet praktike të tekstit mësimor, sipas niveleve të nxënësve? | 2 | 4 |
| 7 | Libri i mësuesit | 0 | 7 |
| a) | A ka teksti libër mësuesi? | 0 | 4 |
| b) | Sa e ndihmon mësuesin në hartimin e planit, në zhvillimin e projekteve, në detyrat e shtëpisë, në çdo mësim individual. | 0 | 3 |
| 8 | Vlerësimi i autorëve të tekstit | 15 | 25 |
| a) | Formimi universitar dhe pasuniversitar i autorëve | 8 | 12 |
| b) | Përvoja pedagogjike | 6 | 8 |
| c) | Veprimtaria botuese e tyre. | 1 | 5 |
| | Vlerësimi i përgjithshëm | 56 | 100 |

Kalimi i fazës së parë për miratimin e tekstit:

- Nëse teksti vlerësohet me më pak se 80 pikë, ai nuk kalon në fazën e dytë.
- Nëse nuk plotësohet numri i pikëve të mjaftueshme minimale, për të paktën një tregues ose nën tregues, teksti nuk miratohet nga ana e përmbytjes.
- Vlerësuesit mund të rekomandojnë përmirësime në tekst, por këto përmirësime nuk ndikojnë në numrin e pikëve që jep vlerësuesi për çdo tregues.

2. Çmimi i tekstit shkollor

- Llogaritet sipas kësaj formule:

Formula e pikëve të çmimit është

$$p = 55 \cdot \frac{B}{\zeta + b}$$

- ku:
- B dhe b kanë vlera të dhëna në tabelën e koeficienteve për çdo tekst më vete
 - ζ është çmimi në lek që zgjedh botuesi
 - p është numri i pikëve që përftohen për çmimin e zgjedhur nga botuesi.

P.sh.: për tekstin “Dituri natyre” të klasës së katërt, në tabelën e koeficienteve janë dhënë $B = 330$ dhe $b = 30$. Formula e pikëve për këtë tekst është:

$$p = 55 \cdot \frac{330}{\zeta + 30}$$

Nëse botuesi zgjedh çmimin 260 lekë, atëherë në formulën e pikëve, ky çmim vendoset në vend të ζ -së dhe pikët që merr për këtë çmim janë:

$$p = 55 \cdot \frac{330}{\zeta + 30} = 55 \cdot \frac{330}{260 + 30} = 55 \cdot \frac{330}{290} = 62,6$$

Numri i pikëve rrumbullakoset deri në një shifër pas presjes dhjetore.

b) Formula e pikëve të vlerësimit të përgjithshëm është: $P = N + p$,

- ku:
- N është numri i pikëve në vlerësimin e përmbajtjes së tekstit,
 - p është numri i pikëve në vlerësimin e çmimit nga formula më sipër,
 - P është numri i pikëve të vlerësimit të përgjithshëm të tekstit.

3. Vendimi i miratimit ose mosmiratimit të tekstit

a) Bëhet publikisht në prani të të gjitha shtëpive botuese pjesëmarrëse në konkurrim.

b) Pas shpalljes së miratimit me prezumim, shqyrtohen dokumentet e tekstit që ndodhen në zarfin e dyllosur, tashmë të hapur pas shpalljes dhe verifikohet rregullsia dhe përputhshmëria e dokumenteve me kriteret e paketës “Altertekst 2010 - 2011”. Në rast se konstatohen mospërputhje KMT-ja anulon vendimin. Kjo vlen edhe për autorët.

c) Nuk lejohet ndryshimi i çmimit ose kushteve të tjera të afuara nga botuesi për tekstin e paraqitur për miratim, me qëllim ndryshimin e vendimit që është marrë për miratimin ose mosmiratimin e tekstit me qëllim përmirësimin në favor të botuesit të kushteve të paraqitura.

d) KMT miraton paketën e teksteve të lëndës, të paraqitur nga shtëpia botuese, që nënkupton tekstet bazë si dhe tekstet për punë nga nxënësi (fletë pune ose fletore laborator) kur këto janë shpallur në kërkesën e MASH-it. Nëse njëri prej teksteve të paketës nuk miratohet, atëherë e gjithë paketa nuk miratohet për përdorim në shkollë.

4. Certifikimi i tekstit shkollor

4. 1 Që teksti të marrë certifikatën e lejes, duhet të plotësojë këto kushte:

- a) Të ketë grumbulluar të paktën 80 pikë në fazën e parë.
- b) Të ketë grumbulluar të paktën 145 pikë në vlerësimin e përgjithshëm.
- c) Të plotësojë të gjitha vërejtjet, nëse ka të tilla, të cilat do t'i jepen nga KMT-ja.
- d) Të respektojë specifikimet teknike të paraqitura në tabelë.
- e) Të ketë dokumentacionin e plotë që botuesi dorëzon për miratim teksti.
- f) Të bëjë shkarkimin elektronik të tekstit në portalin e MASH-it, në qoftë se ky portal është

i hapur.

4. 2. a) Certifikata e lejes ka afat, të shumtën 3-vjeçar, nëse programet nuk ndryshojnë. Për tekstet e arsimit profesional certifikata e lejes ka afat 5-vjeçar.

b) Në rast se teksti shkollor qarkullon me gabime shkencore, bëhet objekt shqyrtimi në KMT.

VI. DOKUMENTET QË BOTUESI DORËZON PËR APLIKIMIN PËR MIRATIM TEKSTI

Botuesi që aplikon për miratim teksti, dorëzon në KMT, në MASH, dokumentet e kualifikimit dhe ofertat përkatëse, si më poshtë:

(Të gjitha dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer në shqip dhe të noterizuara).

Dokumentet dhe materialet që dorëzohen

1. Dokumente kualifikimi

a) Vendimi i gjykatës për regjistrimin si person juridik, me të drejtë ushtrimi aktiviteti si Shtëpi Botuese.

b) Certifikatë e regjistrimit në organet tatimore për ushtrimin e veprimtarisë në biznesin e botimit.

c) Vërtetim nga Prokuroria e rrethit që Shtëpia Botuese dhe administratori që aplikon në emër të saj nuk janë në ndjekje penale.

d) Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve dhe e Taksave për shlyerjen e detyrimeve përkatëse.

e) Vërtetim nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit që botuesi nuk ka detyrime financiare karshi të tretëve dhe që shtëpia botuese që përfaqëson nuk është në proces falimentimi.

Shënim:

Dokumentet e pikave c), d) dhe e) duhet të jenë jo më të vjetra se tre muaj nga data e dorëzimit në MASH.

2. Dokumentet e ekipit realizues të tekstit dhe të shpërndarjes së tij

a) Deklaratë e botuesit dhe e autorëve që nuk janë në rast të konfliktit të interesave, për të qenë respektivisht pjesëmarrës në tregun konkurrues të teksteve dhe autorë të tekstit, përkundrejt punësimit të tyre në administratën publike të arsimit, të parashikuar në këtë Paketë Informuese (modeli bashkëngjitur).

b) Deklaratë e të drejtave të autorësisë (kopirajt-it) mbi origjinalitetin e veprës në tërësi dhe pjesëve të saj si dhe kopje të akteve ose marrëveshjeve që mund të jenë bërë për aplikimin për marrjen e lejes ose blerjen e elementeve të veçanta të kopirajt-it nga të tretët (modeli bashkëngjitur).

c) Deklaratë për specifikimet teknike të tekstit që dëshmon respektimin e specifikimeve minimale të vëna, si dhe formatin e zgjedhur të tekstit (modeli bashkëngjitur).

d) Deklaratë noteriale të autorëve, të cilët pranojnë botimin e tekstit nga kjo shtëpi botuese.

e) Deklarata për çmimin e shitjes së tekstit (modeli bashkëngjitur).

f) Të japin të dhëna për autorët e teksteve (modeli bashkëngjitur).

g) Të japin të dhëna për ekipin realizues të tekstit si: redaktorin shkencor, redaktorin letrar, etj. (modeli bashkëngjitur).

h) Të paraqesin dy recensa për vlerësimin e tekstit, ku detyrimisht njëri nga recensuesit të jetë pedagog efektiv në universitet.

i) Të japë vitin e krijimit të shtëpisë botuese, adresën e saj, numrin e telefonit, adresën elektronike dhe adresën e magazinës së saj nga do të shpërndahen librat në qarqe (modeli bashkëngjitur).

j) Të dorëzojnë të dhënat e mësipërme për shpërndarësin në secilin rreth (modeli bashkëngjitur).

3. Materiali i tekstit që paraqitet për miratim

a) Pesë kopje të tekstit që paraqitet për miratim, secila me 100% të materialit të tekstit, tërësisht i redaktuar nga ana shkencore, metodike dhe gjuhësore, i faqosur me gjithë figurat, ilustrimet, skicat, hartat e ngjyrat (nëse parashikohen) etj., i shtypur dhe i prerë në trajtë përfundimtare, në llojin e letrës dhe formatin e përzgjedhur sipas specifikimeve teknike, ashtu siç do të dalë nga shtypshkronja.

b) Në çdo tekst të jetë bashkëngjitur lista e të dhënave të autorëve, një kopje, pa identifikuar emrat e tyre dhe botuesin.

c) Në çdo tekst të jetë bashkëngjitur lista e të dhënave për redaktorin shkencor, letrar, recensuesit, disenjuesin, pa identifikuar emrat e tyre dhe botuesin.

d) Të dorëzojë dy recensat e vlerësimit të tekstit, pa identifikuar emrat e recensuesve.

e) Çdo kopje e tekstit të paraqitur të jetë e lidhur në trajtë provizore me vrima e me kapëse plastike me ngjyrë të bardhë ose të zezë, pa përdorur si ballina (kopertinë) kartoncinë apo film.

Shënim:

Asnjë prej kopjeve të tekstit që paraqiten për miratim nuk duhet të përmbajnë shenjat e zakonshme të identifikimit (kopertinën, autorët, emrin apo logon e shtëpisë botuese, etj.), siç do të ishte në gjendjen gati për shitje. Titulli i tekstit në kopjet e dorëzuara duhet të vendoset sipas emërimit në listën e kërkuar dhe të shpallur nga MASH-i dhe jo i stilizuar sipas karakterit të linjës që ka ndjekur shtëpia botuese apo autorët e tekstit. Titulli i stilizuar mund të rivendoset pas miratimit të mundshëm. Titulli të shkruhet me ngjyrë të zezë në llojin e letres së bllokut të librit, me gërma të mëdha shtypi tip “Bookman Old Style”, bold, me madhësi 36-she.

Për tekstet e arsimit profesional dhe ato të pakicave kombëtare paraqiten vetëm dy kopje.

Mënyra e paraqitjes së dokumenteve dhe materialeve

a) Dokumentet e kualifikimit vendosen sipas radhës a) deri në e) në një zarf të bardhë me format A4, që dorëzohet i mbyllur.

b) Dokumentet e ekipit realizues të tekstit dhe të shpërndarjes së tij

Zarfi i dyllosur:

Në një zarf të bardhë me format A4, që dorëzohet i mbyllur e i dyllosur nga botuesi, vendosen sipas radhës të gjitha “Dokumentet e ekipit realizues të tekstit dhe të shpërndarjes së tij” nga pika a) deri në j). Zarfi duhet të jetë pa shenja të jashtme dalluese, që do të mund të zbulonin përkatësinë e tij. Dokumentet e këtij zarfi janë të gjitha të firmosura e, sipas rastit, të vulosura.

Zarfi i padyllosur:

Krahas zarfit të dyllosur me dokumentet e tekstit, dorëzohet dhe një zarf i padyllosur, i bardhë me format A4, me kopje të dokumentave sipas pikave c) dhe e) të “Dokumentet e ekipit realizues të tekstit dhe të shpërndarjes së tij”.

Në këtë rast, këto dokumente nuk do të përmbajnë firma, apo vula si dhe çfarëdo shenjë tjetër që do të mund të lejonin identifikimin e origjinës së tyre (si p.sh, logo, emri, vula apo firma e botuesit ose autorëve etj.). Në rast të kundërt, teksti përjashtohet nga procesi i aplikimit dhe i vlerësimit.

Çdo tekst që paraqitet për miratim ka zarfin e vet të dyllosur dhe atë të padyllosur.

c) Materiali i tekstit që paraqitet për miratim

Kopjet e tekstit që paraqitet për miratim paktohen në letër të bardhë. Mbi çdo pako botuesi shkruan titullin e tekstit. Në çdo pako të futen zarfi i dyllosur dhe zarfi i padyllosur i titullit përkatës.

Kopjet e tekstit si dhe materialet e paketimit duhet të jenë pa shenja ose tregues që do të mund të lejonin identifikimin e autorit ose botuesit. Në raste kur verifikohen shkelje të tilla, teksti përkatës përjashtohet nga procesi i aplikimit dhe i vlerësimit.

Pranimi dhe ruajtja e fshehtësisë së dokumenteve dhe materialeve

a) Zarfi me dokumentet e kualifikimit hapet nga marrësi në dorëzim, juristi i KMT-së, në çastin e dorëzimit dhe në prani të dorëzuesit - përfaqësues i botuesit. Përmbajtja e tij konstatohet në çast dhe dokumentet ruhen nga marrësi në dorëzim. Në të kundërt, aplikimi i botuesit nuk pranohet për verifikim të mëtejshëm.

b) Në çastin kur e gjithë paketa merret në dorëzim, marrësi në dorëzim heton për shenja të jashtme të mundshme në pakot. Nëse nuk gjenden të tilla, më vonë, mbi secilën kopje të tekstit të dorëzuar si dhe në të dy zarfet e dokumenteve të teksteve vendoset i njëjti kod që jep përkatësinë e zarfeve me kopjet e teksteve.

c) Zarfi i dyllosur mbahet i veçuar në një vend të sigurt. Zarfi i padyllosur mbahet edhe ai i veçuar dhe hapet nga KMT-ja vetëm mbasi janë caktuar vlerësimet me pikë për përmbajtjen e tekstit dhe teksti ka kaluar me sukses fazën e parë të miratimit, atë të përmbajtjes.

d) Zarfi i dyllosur që mbahet në kasafortë hapet në çastin e shpalljes së përfundimeve të vlerësimit të teksteve, para të gjithë botuesve të pranishëm, pjesëmarrës në konkurrim. Pasi të jenë shpallur më parë rezultatet e miratimit sipas kodeve, hapen zarfet e dyllosura, në prani të gjithë botuesve dhe zbulohet përkatësia e tekstit të miratuar me botuesin, sipas kodeve të vendosura në zarfe dhe në pakot e tekstit. Botuesi të cilit rezulton se i përkasin të dhënat e zarfit, i dorëzon aty për aty komisionit kopjen e vet të tekstit për të verifikuar edhe një herë njëjtësinë me kopjet që i

përkasin atij zarfi, pra, nëse është njëloj me ato që janë dorëzuar në datën e pranimit. Për këtë qëllim, botuesi duhet të ketë një kopje identike të tekstit, për të vërtetuar përkatësinë dhe këtë duhet ta sjellë me vete ditën e shpalljes së teksteve të miratuara. Më tej, shqyrtimi i posaçëm i dokumenteve që përmban zarfi i dyllosur, përfundon me konfirmimin ose jo të miratimit të tekstit përkatës.

e) Dorëzimi i teksteve nga botuesit bëhet nga secili botues veç e veç, sipas radhës së paraqitjes. Nuk pranohen aplikime pas përfundimit të afatit.

VII. SPECIFIKIME TEKNIKE TË TEKSTEVE TË KËRKUARA

a) Specifikimet teknike të teksteve të kërkuara për vitin 2010-2011

Tabela 1/1

| Nr. | Cikli / Titulli | Numri preventiv i faqeve | Formati i prerë (në cm.) | Numri ngjyrave bllokut | Numri ngjyrave kopertin | Lloji lidhjes |
|-----|---------------------------------------------|--------------------------|--------------------------|------------------------|-------------------------|---------------|
| | Arsimi bazë | | | | | |
| | <i>Klasa III</i> | | | | | |
| 1 | Gjuha frënge | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 2 | Gjuha frënge Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 3 | Gjuha italiane | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 4 | Gjuha italiane Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 5 | Gjuha angleze | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 6 | Gjuha angleze Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| | <i>Klasa IV</i> | | | | | |
| 1 | Gjuha frënge | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 2 | Gjuha frënge Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 3 | Gjuha italiane | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 4 | Gjuha italiane Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 5 | Gjuha angleze | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 6 | Gjuha angleze Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| | <i>Klasa V</i> | | | | | |
| 1 | Gjuha frënge | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 2 | Gjuha frënge Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 3 | Gjuha italiane | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 4 | Gjuha italiane Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 5 | Gjuha angleze | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 6 | Gjuha angleze Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| | <i>Klasa VI</i> | | | | | |
| 1 | Gjuha frënge | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 2 | Gjuha frënge Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 3 | Gjuha italiane | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 4 | Gjuha italiane Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 5 | Gjuha angleze | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 6 | Gjuha angleze Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 7 | Gjuha angleze (për fillestarë) | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 8 | Gjuha angleze (për fillestarë) Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| | <i>Klasa VII</i> | | | | | |
| 1 | Informatikë | 80 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 2 | Gjuha frënge | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 3 | Gjuha frënge Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |

| | | | | | | |
|----------|---------------------------------------------|-----|---------|---|---|---------|
| 4 | Gjuha italiane | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 5 | Gjuha italiane Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 6 | Gjuha angleze | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 7 | Gjuha angleze Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 8 | Gjuha angleze (për fillestarë) | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 9 | Gjuha angleze (për fillestarë) Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| | <i>Klasa VIII</i> | | | | | |
| 1 | Informatikë | 80 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 2 | Gjuha frënge | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 3 | Gjuha frënge Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 4 | Gjuha italiane | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 5 | Gjuha italiane Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 6 | Gjuha angleze | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 7 | Gjuha angleze Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 8 | Gjuha angleze (për fillestarë) | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 9 | Gjuha angleze (për fillestarë) Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| | <i>Klasa IX</i> | | | | | |
| 1 | Gjuhë shqipe | 300 | 18 x 25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 2 | Informatikë | 80 | 18 x 25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 3 | Gjuha frënge | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 4 | Gjuha frënge Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 5 | Gjuha angleze | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 6 | Gjuha angleze Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 7 | Gjuha angleze (për fillestarë) | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 8 | Gjuha angleze (për fillestarë) Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| | Gjinnazi | | | | | ngjitje |
| | <i>Klasa X</i> | | | | | ngjitje |
| <i>I</i> | <i>Lëndë bazë</i> | | | | | ngjitje |
| 1 | Gjuha angleze | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 2 | Gjuha angleze Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 3 | Gjuha angleze për fillestarët | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 4 | Gjuha angleze për fillestarët Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 5 | Gjuha frënge | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 6 | Gjuha frënge Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 7 | Gjuha frënge për fillestarët | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 8 | Gjuha frënge për fillestarët Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 9 | Gjuha italiane | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 10 | Gjuha italiane Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 11 | Gjuha italiane për fillestarët | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 12 | Gjuha italiane për fillestarët Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 13 | Gjuha gjermane për fillestarët | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 14 | Gjuha gjermane për fillestarët Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 15 | Gjuha spanjolle për fillestarët | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |

| | | | | | | |
|---------------------------------------------|----------------------------------------------|-----|---------|---|---|---------|
| 16 | Gjuha spanjolle për fillestarët Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| <i>II Lëndë me zgjedhje</i> | | | | | | |
| 1 | Letërsi | 100 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 2 | Guidë turistike | 80 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 3 | TIK i avancuar | 50 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 4 | Fotografi - Fotoshop | 80 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 5 | Njeriu dhe ndryshimet klimatike | 80 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 6 | Trashëgimia jonë kulturore | 150 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 7 | Historia e artit shqiptar | 80 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| <i>Klasa XI</i> | | | | | | |
| <i>I Kurrikula bërthamë e gjimnazit</i> | | | | | | |
| 1 | Qytetari | 100 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 2 | Edukimi për karrierën | 100 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 3 | Matematikë | 270 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 4 | Teknologjia e informacionit dhe komunikimit | 100 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 5 | Histori e qytetërimit botëror | 180 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 6 | Gjeografia | 100 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 7 | Gjuhë angleze | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 8 | Gjuha angleze Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 9 | Gjuhë frënge | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 10 | Gjuha frënge Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 11 | Gjuhë italiane | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 12 | Gjuha italiane Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 13 | Gjuhë shqipe dhe letërsi | 320 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 14 | Histori e arteve | 100 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| <i>II Kurrikula me zgjedhje të detyruar</i> | | | | | | |
| 1 | Psikologji | 180 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 2 | Sociologji | 180 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 3 | Histori e qytetërimit botëror | 180 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 4 | Trashëgimia kulturore evropiane | 180 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 5 | Matematikë | 180 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 6 | Fizikë | 180 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 7 | Kimi | 180 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 8 | Biologji | 180 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 9 | Gjuhë angleze | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 10 | Gjuha angleze Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 11 | Gjuhë frënge | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 12 | Gjuha frënge Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 13 | Gjuhë italiane | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 14 | Gjuha italiane Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 15 | Gjuha gjermane | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 16 | Gjuha gjermane Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 17 | Gjuha spanjolle | 110 | 22 x 28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 18 | Gjuha spanjolle Fletore pune | 80 | 22 x 28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 19 | Gjuhë shqipe dhe letërsi | 100 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 20 | TIK i avancuar | 50 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| <i>III Kurrikula me zgjedhje të lirë</i> | | | | | | |
| 1 | Kërcim | 100 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 2 | Teatër | 100 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |

| | | | | | | |
|----|---------------------------------------------|-----|-----------|---|---|---------|
| 3 | Edukimi për karrierën | 100 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| | Arsimi i mesëm i përgjithshëm i profilizuar | | | | | |
| | <i>Klasa XII</i> | | | | | |
| 1 | Letërsi dhe gjuhë shqipe (drejtim natyror) | 200 | 16.1x23.4 | 1 | 4 | ngjitje |
| 2 | Letërsi dhe gjuhë shqipe (drejtim shoqëror) | 500 | 16.1x23.4 | 1 | 4 | ngjitje |
| 3 | Matematika 4.1 (drejtimi natyror) | 348 | 18x25 | 1 | 4 | ngjitje |
| 4 | Matematikë 4.2(drejtim natyror) | 232 | 18x25 | 1 | 4 | ngjitje |
| 5 | Matematika 4 (drejtimi shoqëror) | 262 | 18x25 | 1 | 4 | ngjitje |
| 6 | Fizikë (drejtim natyror) | 422 | 18x25 | 2 | 4 | ngjitje |
| 7 | Fizikë (drejtim shoqëror) | 196 | 18x25 | 2 | 4 | ngjitje |
| 8 | Psikologji (drejtimi shoqëror) | 236 | 16.1x23.4 | 1 | 4 | ngjitje |
| 9 | Histori (drejtim natyror) | 200 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 10 | Histori (drejtim shoqëror) | 373 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 11 | Kimia organike (drejtimi natyror) | 270 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 12 | Histori arti | 200 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 13 | Hyrje në filozofi | 116 | 16.1x23.4 | 1 | 4 | ngjitje |
| 14 | Informatika (drejtimi shoqëror) | 200 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 15 | Informatika (drejtimi natyror) | 200 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 16 | Biologjia (drejtimi natyror) | 208 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 17 | Biologjia (drejtimi shoqëror) | 150 | 18x25 | 4 | 4 | ngjitje |
| 18 | Gjeografia | 200 | 18x25 | 2 | 4 | ngjitje |
| 19 | Gjuhë angleze | 110 | 22x28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 20 | Gjuhë angleze Fletore pune | 80 | 22x28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 21 | Gjuhë frënge | 110 | 22x28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 22 | Gjuhë frënge Fletore pune | 80 | 22x28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 23 | Gjuha italiane | 110 | 22x28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 24 | Gjuha italiane Fletore pune | 80 | 22x28 | 1 | 4 | ngjitje |
| 25 | Gjuha gjermane | 110 | 22x28 | 4 | 4 | ngjitje |
| 26 | Gjuha gjermane Fletore pune | 80 | 22x28 | 1 | 4 | ngjitje |

Shënime të rëndësishme:

I. 1) Letra që do të përdoret për bllokun e librit të mos jetë më pak se 80 g/m²; përjashtohet përdorimi i çdo lloji letre me lustër.

2) Për kopertinat e librave mund të përdoret kartoncinë e tipit "matt" ose "Simcot" me peshë 280 - 300 g/m² për librat me ngjitje dhe 250 - 260 g/m² për librat e lidhur me tel kaluar.

3) Për librat deri në 80 faqe lejohet të përdoret lidhja me tel kaluar.

4) Formati i prerë 18 x 25 cm është minimali i lejueshëm. Pranohet format më i madh pa ndryshime të koeficientëve B dhe b.

II.Për specifikimet teknike të kërkuara për titujt e gjuhëve të huaja:

1) Numri i faqeve është preventiv. Tekstet janë të pranueshme mbi apo nën atë numër faqesh.

2) Formati është i mesatarizuar për efekt të përcaktimit të koeficientëve B dhe b. Tekstet do të pranohen me formatet që do të paraqiten.

3) Deri në 80 faqe është e pranueshme lidhja me tel kaluar. Nuk përjashtohet lidhja me ngjitje.

4) Pranohen fletore pune me ngjyra, pa ndryshim të koeficientëve B dhe b.

b) Specifikimet teknike të teksteve të kërkuara për vitin 2011-2012 do të jenë në shtojcën e paketës " Altertekst 2010-2011".

VIII. KOEFICIENTËT E FORMULËS SË LLOGARITJES SË ÇMIMIT

a) Koeficientet B dhe b për tekstet e kërkuara në vitin shkollor 2010-2011

b)

| Nr. | Koeficientët e formulës së vlerësimit të çmimit, viti shkollor 2010 - 2011 | B | B |
|-----|----------------------------------------------------------------------------|-----|----|
| | Klasa III | | |
| 1 | Gjuha frënge | 451 | 41 |
| 2 | Gjuha frënge Fletore pune | 237 | 22 |
| 3 | Gjuha italiane | 451 | 41 |
| 4 | Gjuha italiane Fletore pune | 237 | 22 |
| 5 | Gjuha angleze | 451 | 41 |
| 6 | Gjuha angleze Fletore pune | 237 | 22 |
| | Klasa IV | | |
| 1 | Gjuha frënge | 451 | 41 |
| 2 | Gjuha frënge Fletore pune | 237 | 22 |
| 3 | Gjuha italiane | 451 | 41 |
| 4 | Gjuha italiane Fletore pune | 237 | 22 |
| 5 | Gjuha angleze | 451 | 41 |
| 6 | Gjuha angleze Fletore pune | 237 | 22 |
| | Klasa V | | |
